



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. protokollit 01/94/19
Me datë: 20.03.19
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 30 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve Nr. 06/L-085 i datës 23.11.2018, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin zyrtarit përgjegjës për Mbrojtjen e Sinjalizuesve

1. **Z. Arben Gashi**, i sistemuar në vendin e punës Zyrtar për Integritet Evropian në Komunën e Rahovecit, **CAKTOHET**:

1.1. Zyrtar përgjegjës për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për Mbrojtjen e Sinjalizuesve janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve Nr. 06/L-085 të datës 23.11.2018.
3. Obligohet z. Arben Gashi që të veproj duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve Nr. 06/L-085 si dhe akteve nënligjore që dalin nga legjislacioni në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- z. Arben Gashi,
- Agjencisë Kundër Korrupsionit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës

